



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic

Prosecution

Autoriteti Kompetent / Kryeprokurori

AD.nr.11/2024

Datë: 30.07.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me ankesën disiplinore nga av.A [REDACTED] B [REDACTED] përfaqësues i autorizuar i të pandehurit M [REDACTED] B [REDACTED] ndaj prokurores F [REDACTED] C [REDACTED] Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 30.07.2024 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa kundër F [REDACTED] C [REDACTED] Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, pasi që duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 2, pika 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, veprimet e prokurores nuk paraqesin shkelje disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 16.07.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, përmes Këshillit Prokurorial të Kosovës ka pranuar ankesën disiplinore të ushtruar nga av.A [REDACTED] B [REDACTED] kundër F [REDACTED] C [REDACTED] Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, me pretendimet se prokurorja e lartcekur qëllimisht po i zvarritë hetimet, duke mos i marrë në pyetje të pandehurit edhe pse të njëjtët janë nën masën e paraburgimit që

tre (3) muaj, pa asnjë bazë të ligjshme, duke shkelur detyrimet ligjore të kufizimit të lirisë së të pandehurve me masën e paraburgimit, kur kjo masë parashihet të caktohet vetëm në rrethana të rënda dhe të skajshme kur masat e tjera alternative nuk janë të përshtatshme dhe mund të ndikojnë në zhvillimin normal të procedurës penale, e me këto veprime pala e cila ka parashtruar këtë ankesë disiplinore pretendon se prokurorja F [REDACTED] C [REDACTED] është përfshirë në shkelje disiplinore të parapara me Ligjin Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurores F [REDACTED] C [REDACTED]

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

- Me datë 16.07.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore me numër AD.nr.11/2024.
- Me datë 17.07.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimin e ankesës.

Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, nga Policia e Kosovës, NJHP-Prishtinë, më datë 17.04.2024 ka pranuar kallëzimin penal me nr. Rasti [REDACTED] datës 16.04.2024, kundër të dyshuarve: M [REDACTED] B [REDACTED] B [REDACTED] H [REDACTED] dhe A [REDACTED] O [REDACTED] I [REDACTED] O [REDACTED] me NN persona, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se të njëjtit kanë kryer veprat penale: Vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 lidhur me nenin 28 dhe 33 i KPRK-së.

Kallëzimit penal të lartcekur, Policia ia ka bashkangjitur: Raportin fillestar të incidentit, deklaratat e të dyshuarve, deklaratat e dëshmitarëve, raportet e zyrtarëve policorë, vërtetimi mbi sekuestrimin e gëzhgojave në vendin e ngjarjes dhe automjeteve, të armës së zjarrit, lista e armës së sekuestruar, kërkesat për tërheqjen e video-incizimeve dhe shkresat tjera të lëndës.

Kurse kallëzimi penal është ushtruar në mungesë të mbrojtjes së dhënë nga të pandehurit I [REDACTED] O [REDACTED] dhe B [REDACTED] H [REDACTED] ngase kanë ikur nga vendi i ngjarjes dhe të njëjtit ende janë në arrati.

Kallëzimi penal është regjistruar në shkrimoren e kësaj prokurorie duke marrë numrin PP.I.nr. [REDAKTUAR], dhe i ka mbetur në trajtim të mëtejshme prokurores F. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] meqë e njëjta ka qenë prokurore kujdestare në ditën kur edhe dyshohet të jenë kryer veprat penale.

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, respektivisht prokurorja F. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] e cila është subjekt e kësaj ankese disiplinore, pas pranimi të kallëzimit të lartcekur penal, më datë 17.04.2024 ka nxjerr aktvendimin për fillimin e hetimeve për shkak të dyshimit të bazuar se të pandehurit e lartcekur ishin të përfshirë në kryerjen e veprave penale si ne vijim:

I. I pandehuri M. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] në ndihmë nga B. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] do të kryente veprën penale: Vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 par. 1, pika 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 33, të Kodit Nr. 06L-074 Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa i pandehuri A. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] dhe I. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] në ndihmë nga persona NN, do të kryente veprën penale: Vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 par. 1, pika 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 28 të Kodit Nr. 06L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

II. Ndërsa të pandehurit A. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] dhe I. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] në ndihmë nga persona NN, do të kryenin veprën penale: Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Njëherit në bazë të kërkesës së Prokurorit të Shtetit, Gjyqtari i procedurës paraprake, më datën 18.04.2024, ka mbajtur seancën për caktimin e paraburgimit, pas së cilës i ka caktuar paraburgimin të pandehurve M. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] dhe A. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] në kohëzgjatje prej një (1) muaj, respektivisht deri më datën 15.05.2024.

Ndërkaq, në bazë të kërkesës së Prokurorit të Shtetit, Gjyqtari i procedurës paraprake, më datën 15.05.2024, me Aktvendim nën shenjë PPRKR.nr.89/2024 u ka vazhduar masën e paraburgimit të pandehurve M. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] dhe A. [REDAKTUAR] O. [REDAKTUAR] në kohëzgjatje prej dy (2) muaj, respektivisht nga data 15.05.2024 deri më datën 14.07.2024, ndërkaq me aktvendimin e datës 12.07.2024, pas kërkesës së prokurorisë, Gjykata të pandehurve të lartcekur, ju ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje edhe prej dy (2) muaj të tjerë, deri më datë 13.09.2024.

Prokurorja e çështjes, znj. R. [REDACTED] G. [REDACTED] në vazhden e ushtrimit të autorizimeve të saj ligjore ka ndërmarrë një sërë veprimesh fillestare në grumbullimin e provave të ligjshme në vijim:

për të cilat prokurori i çështjes do të vazhdojë

me analizimin e të gjitha të gjeturave nga këto ekspertiza, në mënyrë që të shihet nëse ka nevojë të ndërmerret ndonjë veprim tjetër hetimor.

Gjithashtu, prokurorja e çështjes me datë 22.04.2024 ka autorizuar Policinë e Kosovës - NJHP

Në bazë të kërkesës së Prokurorit të Shtetit, Gjyqtari i procedurës paraprake më datën 16.05.2024 ka lëshuar Urdhër arrest për të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED] dhe I [REDACTED] O [REDACTED] të cilët gjenden në arrati, e të cilët kanë qenë të paçastshëm për organin e ndjekjes edhe përkundër tentativave për ekspedimin e ftesave për të njëjtit për t'u paraqitur para Prokurorit të Shtetit. Gjithashtu, më datë 17.07.2024, prokurorja e çështjes i është drejtuar gjykatës me kërkesën për lëshimin e letër rreshtimit për të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED] dhe I [REDACTED] O [REDACTED]

Duke analizuar lëndën penale PP/L.nr. [REDACTED], pretendimet e parashtruesit të kësaj ankese disiplinore si dhe veprimet e ndërmarra nga prokurorja F [REDACTED] C [REDACTED] Autoriteti Kompetent vlerëson se veprimet e saj në trajtimin e kësaj çështje penale nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit nga ana e prokurores F [REDACTED] C [REDACTED] mbi pretendimet ankimore.

- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/I.nr. [REDACTED]

Pretendimet e palës ankuese

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në cilësinë e Autoritetit Kompetent, me datë 16.07.2024, përmes Këshillit Prokurorial të Kosovës, e nga parashtruesi i ankesës disiplinore av. A [REDACTED] B [REDACTED], përfaqësues i autorizuar i të pandehurit M [REDACTED] B [REDACTED] në lëndën penale PP.I.nr. [REDACTED] ka pranuar ankesën disiplinore ndaj prokurores së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamentit të Krimeve të Rënda, znj. F [REDACTED] C [REDACTED]. Në ankesën disiplinore, pala ankuese pretendon se prokurorja e çështjes F [REDACTED] C [REDACTED] në mënyrë tendencioze dhe të qëllimshme po i prolongon hetimet në çështjen penale nën shenjë PP.I.nr. [REDACTED], duke mos i marrë në pyetje të pandehurit në këtë çështje penale, përfshirë edhe të mbrojturin e tij, ashtu që pa asnjë bazë ligjore është duke e mbajtur të mbrojturin e tij nën masën e paraburgimit.

Deklarimet e Prokurores F [REDACTED] C [REDACTED] lidhur me pretendimet ankimore

Prokurorja F [REDACTED] C [REDACTED] përmes raportit të dorëzuar tek Autoriteti Kompetent me datë 22.07.2024, lidhur me pretendimet e ankuesit, ndër të tjera ka deklaruar se: *"Të gjitha veprimet e mundshme për të shpejtuar zbatimin e procedurës, deri më tani janë ndërmarrë, dhe të gjitha provat e siguruara, në këtë fazë të procedurës, dëshmojnë se të pandehurit ishin përfshirë në kryerjen e veprave penale që ju vihen në barrë. Ju njoftoj se kjo lëndë në trajtim më ka takuar pasi që kam qenë kujdestare dhe përveç kësaj lëndë i kam pasur edhe tri raste tjera me paraburgim në të njëjtin muaj kurse, gjithsejtë përgjatë muajve të kujdestarisë me paraburgim i kam pasur nënte raste, mirëpo asnjëri nga avokatet e rasteve tjera nuk ka ushtruar presion për procedimin e shpejte të lëndës përveç mbrojtësit të të pandehurit M [REDACTED] B [REDACTED] av. A [REDACTED] B [REDACTED] i cili brenda muajit të parë të caktimit të paraburgimit verbalisht ka kërkuar të merret në pyetje pala e tij, edhe pse nuk ishte pranuar asnjë raport i ekspertimit në zyrë. Avokati A [REDACTED] B [REDACTED] ka thirrur disa here në telefonin e zyrës (derisa ia kam tërhequr vërejtjen për pengim në punë) duke kërkuar të merret pala në pyetje, kudo që më ka takuar në seancat e tjera në gjykatë ka kërkuar po ashtu të merret pala e tij në pyetje. Përgjigja ime ka qenë do të merret në pyetje sa më shpejtë, posa të sigurohen ekspertizat. Njëkohësisht av. A [REDACTED] B [REDACTED] ka paraqitur kërkesë me shkrim për përshpejtim të marrjes në pyetje të palës duke ju drejtuar juve kryeprokuror dhe më datë 13 maj 2024 kam pranuar kërkesën me shkrim. Po ashtu nga zyra e juaj, më datë 22 maj 2023, kam pranuar kërkesën drejtuar Këshillit Prokurorial dhe zyrës së*

Kryeprokurorit të shtetit më kërkesën e njëjtë. Kurse, më datë 17.07.2024 mu është drejtuar më shkrim përmes zyrës së shkrimore duke kërkuar të merret në pyetje pala të cilin e mbrojnë pasi që ekspertiza e ADN-së do të vonohet me muaj të tërë, kurse ekspertiza e gëzhgojave të fishekut nuk bëhet më nga Agjencioni i Forenzikës. Sa i përket kësaj kërkesës së fundit av. B. [REDAKTUAR] përveç se po mundohet ta luan rolin e prokurorit është duke e kryer edhe punën e eksperteve të Agjencionit të Forenzikës edhe të Policisë. Presioni i tij, në fund kurorëzohet më ankesën e datës 11.07.2024 drejtuar Këshillit Prokurorial të Kosovës me kërkesën për ndërmarrjen e veprimeve disiplinore ndaj meje, për shkak të zvarritjes së qëllimshme të hetimeve penale. Lidhur me veprimet e ndërmarra në këtë çështje penale, unë jam përpjekur përtej mundësive dhe volumit të lëndëve me paraburgim dhe angazhimeve tjera në punë ti kryej sa më shpejtë që mundem sepse kjo me konvenon edhe mua për vlerësimin e performancës por, ka qenë e pamundshme ngase raportet e ekspertimit janë pranuar kohë pas kohe dhe tani jam në pritje të raportit të fundit të ekspertimit, si dëshmi të marrur nga vendi i ngjarjes. Për asnjë çmim në këtë rast as në raste tjera, unë nuk do të bie nën nivelin e profesionalizmit që kam, ndikimit të avokatit dhe betimit që e kam dhënë për pozitën e Prokurorit të Shtetit. Në një kërkesë në mes rreshtave të av. B. [REDAKTUAR] nënvizohet se, kinse unë avokatit i kam premtuar verbalisht që nga muaji maj, se do ta marrë në pyetje të mbrojturin e tij. E vërteta është se i kam thënë sa më shpejtë që mundem duke shpresuar se ekspertimet kryhen shpejtë, por jo premtim sepse kjo fjalë bartë me vete shpërblim material, e unë punoj me respekt dhe ndërgjegje, nuk i dua parat e askujt përveç të prokurorit, siç jam e thirrur. Për fund, ju informoj se të pandehurin M. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] nuk e njoh përveç kur e kam mbajtur seancën e paraburgimit dhe asnjë nga palët e tjera në këtë rast nuk i njoh nga asnjë mënyrë dhe nuk e zvarriti qëllimisht procedimin e hetimit siç ka pretenduar mbrojtësi i të pandehurit. Përfundimisht konsideroj se nga ime si prokurore e çështjes të gjitha palët e përfshira në këtë rast janë duke u trajtuar në mënyrë të barabartë, në respektim të ligjit dhe se në asnjë formë gjatë hetimit e trajtimit të kësaj lënde nuk kam bërë asnjë lloj shkelje të Kodit të Etikës, të Ligjit, e as të Betimit të Prokurorit të Shtetit.”

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se në veprimet e prokurores F. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] nuk gjejmë elemente të shkeljeve disiplinore të pretenduara nga pala ankuese, të cilat do të binin ndesh me Ligjin Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas pranimit të ankesës disiplinore nga ana e palës ankuese, ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palës ankuese, ka shqyrtuar shkresat e lëndës penale PP/I.nr. [REDAKTUAR] ka

kërkuar raport me shkrim nga prokurorja F. [REDACTED] C. [REDACTED] ndaj të cilës është ushtruar ankesa disiplinore dhe pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve, në kuptim të nenit 9, paragrafi 6, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka ardhur në përfundim se ankesa disiplinore është e pabazuar dhe se prokurorja F. [REDACTED] C. [REDACTED] nuk është përfshirë në veprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore.

Pretendimet e palës ankuese se prokurorja F. [REDACTED] C. [REDACTED] është përfshirë në shkelje disiplinore duke i zvarritur hetimet, duke mos marrë palët e pandehura në pyetje dhe duke ju vazhduar masën e paraburgimit pa asnjë bazë ligjore, këto pretendime nuk qëndrojnë për arsyt si në vijim:

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 149 paragrafi 1 ka paraparë se: *"Përveç rasteve të parapara në nenin 234, paragrafi 2 të këtij Kodi, i pandehuri duhet të merret në pyetje nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës. Nëse i pandehuri hetohet për vepër apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është deri në tre (3) vjet burgim, mjafton që i dyshuari apo i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit."* Në bazë të kësaj dispozite ligjore, rrjedh detyrimi i prokurorit të shtetit për marrjen në pyetje të të pandehurve në këtë çështje penale, duke marrë parasysh edhe dënimin e paraparë për këtë vepër penale për të cilën dyshohen ta kenë kryer të pandehurit. Çështja se kur ftohen të pandehurit që të merren në pyetje nga ana e Prokurorit të Shtetit është në diskrecionin e prokurorit të çështjes, gjithmonë duke pasur parasysh edhe respektimin e afateve ligjore të hetimeve. Në nenin 157, paragrafi 1 janë paraparë afatet kohore të hetimit ashtu që: *"Nëse hetimi është filluar, ai përfundon brenda dy (2) viteve"*, me mundësi të parashtrimit të kërkesës së prokurorit të shtetit për zgjatje të hetimit edhe deri në një (1) vit, në rrethana të parapara me ligj. Siç kemi vërtetuar nga shikimi i shkresave të lëndës, me datë 17.04.2024 është marrë aktvendimi për fillimin e hetimeve dhe pas këtij aktvendimi janë marrë edhe një sërë veprimesh procedurale nga ana e prokurores së çështjes, përfshirë edhe urdhëresa për ekzaminim dhe aktvendime për ekspertim nga institucionet gjegjëse, e për të cilat është në pritje të raporteve nga këto institucione, andaj në këtë drejtim nëse prokurorja e çështjes vlerëson se së pari duhen siguruar provat materiale, e pastaj të merren në pyetje të pandehurit, është tërësisht në diskrecionin e saj se si i zhvillon hetimet për lëndët të cilat ajo i ka në trajtim.

Pretendimi tjetër i palës ankuese se të mbrojturit të tij i është vazhduar masa e paraburgimit pa bazë ligjore, duke mos ju caktuar ndonjë masë alternative, duhet cekur se prokurorja F. [REDACTED] C. [REDACTED] ka parashtruar kërkesën për caktimin e paraburgimit, e pastaj edhe kërkesat për vazhdimin

e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit M [REDACTED] B [REDACTED] dhe A [REDACTED] O [REDACTED] ku duke vendosur mbi këto kërkesa, Gjykata kishte vendosur që t'i caktojë dhe vazhdojë paraburgimin të lartcekurve. Sidoqoftë, Gjykata pavarësisht kërkesës së Prokurorit të Shtetit, me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë, detyrohet t'i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa e butë. Gjykata ka vlerësuar rrethanat e rastit dhe ka gjetur se janë plotësuar kushtet për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit ndaj të lartcekurve dhe ka vlerësuar se masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurve do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e tyre në procedurë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale. Pala e cila ka paraqitur këtë ankesë disiplinore, mbi pretendimet se caktimi i paraburgimit ndaj të mbrojturit të tij është ligjërisht i pabazuar, ka pasur të drejtën e atakimit të këtij vendimi gjyqësor brenda dyzet e tetë (48) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Rritheksojmë se kërkesat e Prokurorit të Shtetit për sigurimin e pranisë së të pandehurve në procedurë i vlerëson gjykata, ligjshmëria dhe arsyeshmëria e kërkesave të tilla nuk është kompetencë e vlerësimit nga ana e palëve në procedurë e as e përfaqësuesve të tyre, por është kompetencë kryekëput e gjykatës kompetente, e pastaj edhe e një gjykate më të lartë në rast të atakimit të vendimit të shkallës së parë.

Në kontekst të veprimeve të lartpërmendura, si Autoritet Kompetent vlerësojmë se nuk është provuar se Prokurorja F [REDACTED] C [REDACTED] ka kryer shkelje disiplinore, shkelje këto të cilat do të binin ndesh me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe do të paraqisnin bazë të mjaftueshme për parashtrimin e kërkesës për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj prokurores në fjalë, në kuptim të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent vlerësojmë se veprimet e prokurores F [REDACTED] C [REDACTED] janë konform autorizimeve ligjore dhe kushtetuese të Prokurorit të Shtetit, dhe në asnjë veprim të prokurores nuk janë gjetur elemente të shkeljeve disiplinore, që korrespondojnë në shkelje të dispozitave të procedurës penale apo zvarritjes së hetimeve. Në këtë drejtim konsiderojmë se, veprimet e prokurores F [REDACTED] C [REDACTED] kanë qenë në kuadër të ushtrimit të funksioneve prokuroriale në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kuptim të nenit 5, paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit.

Nga gjithë ajo çfarë u konstatua më lartë, kemi gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar se veprimet e prokurores F [REDACTED] C [REDACTED]

paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6, paragrafi 2, pika 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kuptim të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankesën disiplinore e **REFUZOJMË SI TË PABAZUAR**.

Me sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

-Këshillit Prokurorial të Kosovës

-Arkivës

